



Prishtinë, 19 maj 2016
Kodi i ZRRE-së: V_813_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 19 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimin për lëshimin e Autorizimit Final V-402-2012 të datës 15 qershor 2012 lëshuar shoqërisë "Kelkos Energy" Sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, për HC "Bellaja me kapacitet të instaluar prej 9.2 MW, dhe HC Deçan me kapacitet të instaluar prej 8.4 MW, në Lumin lumëbardhi i Deçanit, komuna e Deçanit;
- Kërkesën për modifikimin të Autorizimit Final V-402-2012 të datës 15 qershor 2012 për ndryshimin e kapacitetit gjenerues të HC Bellaja nga kapaciteti fillestar i instaluar 9.2 MW prej në kapacitetin instalues prej 8.06 MW dhe HC Deçan nga kapaciteti fillestar i instaluar prej 8.4 MW në kapacitetin instalues prej 9.8 MW, në lumin lumëbardhi i Deçanit, Komuna e Deçanit, të datës 20.04.2016 të shoqërisë "Kelkos Energy" Sh.p.k., me adresë rruga "Sali Çeku", ndërtesa Gogaj, nr. 14, 51000 Deçan, Republika e Kosovës;
- Vendimin nr. 1287/16 –ZSP -356 DU/16 për ndryshimin e vendimit për Lejen Ujore me Nr. 1839/11 –ZSP-69/12, të datës 09.02.2012, për HC Bellaja, të lëshuar nga MMPH, të datës 24.03.2016, dhe
- Vendimin nr. 1287/16 –ZSP -355 DU/16 për ndryshimin e vendimit për Lejen Ujore me Nr. 1839/11 –ZSP-69/12, të datës 09.02.2012, për HC Deçan, të lëshuar nga MMPH, të datës 24.03.2016,

në seancën e mbajtur me datë 19 maj 2016 nxori këtë:

V E N D I M PËR MODIFIKIM TË AUTORIZIMIT FINAL

- I lëshohet **VENDIMI PËR MODIFIKIMIN E AUTORIZIMIT FINAL V-402-2012** i datës 15 qershor 2012, shoqërisë "Kelkos Energy" Sh.p.k., për HC Bellaja nga kapaciteti fillestar i instaluar prej 9.2 MW në kapacitetin instalues prej 8.06 MW sipas Lejes ndërtimore dhe vendimit nr. 1287/16 –ZSP -355 DU/16 për ndryshimin e vendimit për Lejen Ujore me Nr. 1839/11 –ZSP-69/12, të datës 09.02.2012, të lëshuar nga MMPH me datë 24.03.2016 dhe HC Deçan nga kapaciteti fillestar i instaluar prej 8.4 MW në kapacitetin instalues prej 9.8 MW sipas Lejes ndërtimore dhe vendimit nr. 1287/16 –ZSP -355 DU/16 për ndryshimin e vendimit për Lejen Ujore me Nr. 1839/11 –ZSP-



69/12, të datës 09.02.2012, të lëshuar nga MMPH, me datë 24.03.2016, në Lokacionin lumëbardhi i Deçanit, Komuna e Deçanit.

Arsyetim

- ZRRE me datë 09.08.2010 nga shoqëria “Kelkos Energy” SH.P.K., ka pranuar kërkesën/aplikacionin për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, për HC “Bellaja me kapacitet të instaluar prej 9.2 MW, HC Deçan me kapacitet të instaluar prej 8.4 MW dhe HC Lumëbardhi 5.5 MW, Lokacioni Lumi lumëbardhi i Deçanit, komuna e Deçanit.
- ZRRE pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, me datë 11 nëntor 2010 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_296_2010, dhe ka udhëzuar aplikuesin që t’i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkojnë me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- ZRRE me datë 29.02.2013 ka pranuar kërkesën për shëndrrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC Bellaja me kapacitet të instaluar prej 9.2 MW, dhe HC Deçan me kapacitet të instaluar prej 8.4 MW Lokacioni Lumi lumëbardhi i Deçanit, komuna e Deçanit, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, të drejtat mbi shfrytëzimin e ujit, Lejen ndërtimore dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- ZRRE me datë 15 qershor 2013 ka lëshuar Vendimin për Autorizimin Final V-402-2012 të datës shoqërisë “ Kelkos Energy” Sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, për HC Bellaja me kapacitet të instaluar prej 9.2 MW, dhe HC Deçan me kapacitet të instaluar prej 8.4 MW Lokacioni Lumi lumëbardhi i Deçanit, komuna e Deçanit.
- ZRRE me datë 20.04.2016 ka pranuar kërkesën për Modifikimin të Autorizimit Final për ndryshimin e kapacitetit gjenerues të HC Bellaja nga kapaciteti fillestar i instaluar prej 9.2 MW në kapacitetin instalues prej 8.06 MW dhe HC Deçan nga kapaciteti fillestar i instaluar prej 8.4 MW në kapacitetin instalues prej 9.8 MW, në lumin lumëbardhi i Deçanit, Komuna e Deçanit.
- ZRRE me datë 20.04.2016 ka pranuar vendimin nr. 1287/16 –ZSP -356 DU/16 për ndryshimin e vendimit për Lejen Ujore me Nr. 1839/11 –ZSP-69/12, të datës 09.02.2012, për HC Bellaja, të lëshuar nga MMPH, të datës 24.03.2016 dhe vendimin nr. 1287/16 –ZSP -355 DU/16 për ndryshimin e vendimit për Lejen Ujore me Nr. 1839/11 –ZSP-69/12, të datës 09.02.2012, për HC Deçan, të lëshuar nga MMPH, të datës 24.03.2016.
- Shoqëria “Kelkos Energy” sh.p.k., kërkesën për modifikim të autorizimit final e ka bazuar në atë: se gjatë ndërtimit paralel të të dyja fazave HC Bellaja dhe HC Deçan, përmirësimi i parametrave gjeoteknike dhe energjetike kanë rezultuar në një dizajnë të përshtatur/optimizuar për të dy njësitë gjeneruese, për shkak të logjikës së kaskadës operative.



- ZRRE, pas vlerësimit të kërkesës për Modifikim të Autorizimit dhe dëshmime të bashkangjitura dhe pranimit të vendimin për ndryshimin e vendimeve për Lejet Ujore dhe lejet ndërtimore të kërkuara nga ZRRE, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


II. **Obligohet** shoqëria “Kelkos Energy” SH.P.K., që pas Pranimit Teknik të HC Bellaja dhe HC Deçan, të sjell Certifikatën e Përdorimit të lëshuar nga Organi kompetent, dhe Lejen për Shfrytëzim Ujor të lëshuar nga MMPH.

III. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.


IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Enver Halimi, kryesues


Krenar Bujupi, anëtar


Arsim Janova, anëtar


Qemajl Mustafa, anëtar


Besim Sejfi, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës
- Komunës së Deçanit
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së